



Policia arreston të dyshuarin për vrasjen në Pataqan të Klinës

KRONIKA | April 16, 2022 - 11:10

SHPËRNDAJE: [f](#) [t](#)

Policia e Kosovës ka bërë të ditur se ka arrestuar një të dyshuar për vrasjen në Pataqan të Klinës.

Sipas njoftimit të PK-së thuhet se më 15 prill 2022, rreth orës 16:40, Policia është informuar për një rast, rrahje i cili ka ndodhur në fshatin Pataqan-Klinë, raporton Zeri.info..

“Derisa Policia ishte në kërkim të dyshuarve, është njoftuar se një person është në QKMF Klinë, i cili ishte i plagosur me armë zjarri dhe nga aty me autoambulancë është dërguar ne spitalin rajonal në Pejë, ku nga mjeku kujdestar është konstatuar vdekja e viktimës”, thuhet në njoftimin e PK-së.

Tutje mësohet se në vend ngjarje kanë dalë të gjitha njësitet kompetente të Drejtorisë Rajonale të Policisë në Pejë, gjithashtu prokurori i shtetit dhe Gjyqtari i procedurës paraprake.

Në njoftimin e Policisë më tej bëhet e ditur se nga Gjykata themelore ne Pejë, me urdhër të gjyqtarit janë kontrolluar/bastisur katër lokacione (shtëpi), në tri nga to nuk është gjetur asgjë e jashtëligjshme, ndërsa në shtëpinë e të dyshuarit: A.N. lindur me 1967, janë gjetur dhe sekuestruar, tetë armë të llojeve të ndryshme, karikator dhe municion.

Trupi i pa jetë i viktimës me urdhër të prokurorit të shtetit është dërguar në institutin e mjekësisë ligjore (IML) për obduksion.

I dyshuari pas intervistimit me urdhër te Prokurorit të shtetit iu është caktuar masa e ndalimit Policor prej 48- orësh. /Zëri



Të rekomanduara

[Bie nga kati i tretë, vdes një punëtor në Klinë](#)
KRONIKA | April 14, 2022

[Prishtinasi kanoset nga ish-gruaja në rrjetet sociale](#)
KRONIKA | April 14, 2022

[Arrestohet obliqasi pasi plagosi një qen](#)
KRONIKA | April 14, 2022

[Gjobë dhe heqje e patentës ndaj dy shoferëve në Ferizaj për tejkalim të shpejtësisë](#)
KRONIKA | April 14, 2022

[Policia nis hetimet për tri vdekje të dyshimta në Prishtinë](#)
KRONIKA | April 14, 2022

[Prishtinasi vret veten, i la një mesazh gruas](#)
KRONIKA | April 14, 2022

[U alivanos në Zonën Industriale, vdes në QKUK një shtetas i huaj](#)
KRONIKA | April 13, 2022

[Arrestohet në Gjirokastër 24-vjeçari nga Kosova, u kap me 64 emigrantë në fuqion](#)
KRONIKA | April 12, 2022

Më të lexuarat

- Prishtinasi vret veten, i la një mesazh gruas**

KRONIKA | April 14, 2022
- Vdes në spital kosovari i goditur nga vetura në një autostradë në Zvicër**

KRONIKA | April 15, 2022
- Vritet një person në Zllakuqan, tre të arrestuar**

KRONIKA | April 15, 2022
- Policia nis hetimet për tri vdekje të dyshimta në Prishtinë**

KRONIKA | April 14, 2022
- Të shtëna me armë zjarri në veri të Mitrovicës, Policia jep detaje**

KRONIKA | April 14, 2022
- Bie nga kati i tretë, vdes një punëtor në Klinë**

KRONIKA | April 14, 2022